



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1016/1 Prot.

Tiranë, më 27.09.2023

V E N D I M

Nr.191, Datë 27.09.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.173 regj, datë 20.09.2023, paraqitur nga ankuesi S.B, kundër Filialit të Postës Shqiptare sh.a në Lushnje. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi S.B shpjegon se, ka qenë në marrëdhënie pune në Filialin e Postës Shqiptare sh.a në Lushnje, me detyrë arkëtar terreni për OSHEE dhe shpërndarës. Z. B shpjegon se e kanë larguar nga puna në korrik të vitit 2018. Në momentin e largimit nga puna ankuesi pretendon se nuk e kanë paguar për muajin prill 2014, pagesën e shërbimit të transportit që bënte në fshat dhe nuk e kanë lejuar të bënte asnjë muaj pushim sipas ligjit. z. B pretendon se, arsyeja e largimit nga puna është fakti që ai vazhdimisht bënte kritika në lidhje me punën.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rikthimin në punë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës, bazuar në faktet dhe kërkimet e parashtruara nga ankuesi, dokumentacionin e administruar, si dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh”, të LMD, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese”*, Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor, për arsyet e mëposhtme:

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga ankuesi, rezulton se z.S.B ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare sh.a, Filiali Lushnje. Me urdhrin nr.35, datë 18.07.2018, të Drejtorit të Postës Shqiptare sh.a Filiali Lushnje, ankuesi është liruar nga detyra. Ankuesi e ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës së punës në gjykatë dhe me vendimin nr. 533 datë 10.07.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka vendosur që Posta Shqiptare sh.a duhet të dëmshpreblejë z. S.B në total me 12 (dymbëdhjetë) muaj pagë, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, për mosrespektim të afatit kontraktual për zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe dëmshpërblimin për vjetërsi në punë. Ky vendim është kundërshtuar nga Posta Shqiptare sh.a dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.314, datë 22.11.2022, ka vendosur lënin në fuqi të vendimit të sipërcituar.

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi pretendon se largimi i tij nga puna ka ndodhur për shkak se ai në mënyrë të vazhdueshme ka bërë kritika në lidhje me punën. Ankuesi gjithashtu pretendon se, nuk është paguar për muajin prill 2014, nuk ka marrë pagesën e shërbimit të transportit, si dhe nuk ka marrë pagesën për pushimet vjetore të pakryera.

Sa më sipër, rezulton se, diskriminimi i pretenduar nga ankuesi, pra largimi nga puna, ka ndodhur në datën 18.07.2018. Përpara kësaj date rezultojnë të ketë ndodhur edhe momentet e tjera të pretenduara nga ankuesi si diskriminuuese, në lidhje me të drejtat dhe përfitimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, të cilat ankuesi pretendon se i janë shkelur, si mospagesa për muajin prill 2014, mospagesa e pushime të pakryera apo mospagesa e shërbimit të transportit. Pavarësisht se ankuesi nuk i përcakton në kohë se kur janë shkelur të drejtat dhe përfitimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, meqënëse marrëdhënia e punës ka përfunduar në datën 18.07.2018, detyrimisht ato prezupozohet se kanë ndodhur para kësaj date.

Ankuesi ka depozituar ankesën objekt shqyrtimi në datën 20.09.2023, pra më vonë se 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar, që është data 18.07.2018. Ankuesi ka marrë dijani për diskriminimin e pretenduar, pasi ai e ka kundërshtuar largimin nga puna në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e cila ka disponuar në lidhje me padinë e ankuesit me vendimin e datës 10.07.2019. Në këto kushte ankesa është depozituar më vonë se 2 vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuuese të pretenduar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr. 173, datë 20.09.2023 e paraqitur nga ankuesi S.B, nuk përmbush kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor, dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të shqyrtimit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1/a, nenin 33, pika 4, gërma “dh” dhe nenin 33 pika 10, të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 173 regj., datë 20.09.2023, të paraqitur nga ankuesi S.B kundër Filialit të Postës Shqiptare sh.a Lushnje, pasi nuk përmbush kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “dh”, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim _Jashtë afateve ligjore